



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCAVE
DIREKCIJA JAVNIH SLUŽBI I VANREDNIH STANJA
DIRECTORATE OF PUBLIC SERVICES AND EMERGENCY

Tel: 038/200-46024
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Bazuar në Ligjin për Transportin Rrugor Nr.04/L-179, Vendimin e Kuvendit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.83 të datës 29.08.2025 dhe interpretimit ligjor nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë me numër të protokollit 7063/205 të datës 23.09.2025, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë nxjerr këtë:

THIRRJE PËR APLIKIM

Mënyra e subvencionimit:

Subvencionimi i transportit të udhëtarëve do të bëhet në euro për kilometër (€/km) dhe at:

- Për transportin urban 0.60 [€/km] dhe
- Për transportin urban-periferik 0.40 [€/km].

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacionin e plotësuar nga operatori i transportit.
- Certifikata e regjistrimit të biznesit me informata përcjellëse.
- Letërnjoftimin e pronarit të operatorit të transportit (fotokopje).
- Një kopje të rendit të udhëtimit për linjën që aplikon të vërtetuar nga organi kompetent.
- Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë së transportit.
- Dëshmia për obligimet e kryera ndaj ATK-së.
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit.

Operatorët e transportit të cilët përfitojn nga subvencionimi duhet ti përmbahen këtyre kriterëve dhe kushteve si në vijim:

- Pensionistët, kategoritë e dala nga Lufta dhe personat me aftësi të veçanta përfitojnë biletat falas në të gjitha linjat e transportit urban dhe urban periferik
- Nxënsit e Shkollave të Mesme të Ulëta përfitojnë nga subvencionimi në bileta ditore dhe mujore 50 % në transportin urban – periferik, ndërsa transportin urban bileta ditore dhe mujore do të jetë falas.
- Studentët përfitojnë subvencionim prej 50 % në bileta ditore dhe mujore, vetëm në transportin urban-periferik.

Mënyra dhe periudha e aplikimit:

- Afati i aplikimit fillon nga data 07.10.2025 dhe mbaron me datë 17.10.2025 ora 16:00.
- Dokumentat e kompletuara dorëzohen në të zarfë veçantë në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve, në katin përdhësë, sportelet 1 ; 2 dhe 3.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

